

# Udhëzues për zgjedhjet federale



**X**  
*C'est notre vote*

Vizitoni [elections.ca](https://elections.ca) për informacion zyrtar mbi votimin dhe masat shëndetësore dhe të sigurisë në vend

1-800-463-6868 / [elections.ca](https://elections.ca) / TTY 1-800-361-8935

# Shëndeti dhe siguria juaj është prioriteti ynë


Në qendrën tuaj të votimit, punonjësit e qendrës së votimit do të mbajnë maska. Gjithashtu do të ketë edhe:



Stacione për dezinfektimin e duarve



Shenja dalluese për distancim fizik




Vetëm një punonjës i qendrës së votimit mbrapa pleksiglasit


**Kur shkoni për të votuar, mos harroni:**



Mbani maskën



Ne do iu pajisim me një laps një përdorimësh për të shkruar mbi fletën e votimit, ose ju mund të sillni lapsin ose stilolapsin tuaj








Praktikoni distancimin fizik duke qëndruar së paku 2 metra larg votuesve dhe punonjësve të qendrës së votimit

**Nëse jeni testuar pozitiv ose keni simptoma të COVID-19, apo keni qenë në kontakt me një person që mbart virusin, vizitoni [elections.ca](https://elections.ca) që të aplikoni për të votuar me postë.**

Kjo broshurë është e disponueshme në gjuhë të ndryshme në [elections.ca](https://elections.ca). Për formate të tjera si sistemin braille, gërma të zmadhuara dhe DAISY, na telefononi në **1-800-463-6868** ose **1-800-361-8935** (për shurdh-memecët).

# Sigurohuni që të regjistrohni për të marrë kartën e informacionit të votuesit

Carte d'information de l'électeur	Voter Information Card			
<b>Élection fédérale</b>	<b>Federal Election</b>	<b>Nom ou adresse incorrects? Vérifiez votre inscription à elections.ca.</b>		<b>Incorrect name or address? Check your registration at elections.ca.</b>
<b>Pour voter, vous devez :</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• être citoyen canadien</li><li>• avoir au moins 18 ans le jour de l'élection</li><li>• prouver votre identité et votre adresse</li></ul> <p>Visitez <b>elections.ca</b> pour connaître les pièces d'identité acceptées.</p> <p>Apportez cette carte et vos pièces d'identité pour faciliter le vote.</p>	<b>To vote, you must:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• be a Canadian citizen</li><li>• be at least 18 years old on election day</li><li>• prove your identity and address</li></ul> <p>Visit <b>elections.ca</b> to know what ID is accepted.</p> <p>Bring this card with you, along with ID, to make the voting process easier.</p>	<b>À l'électeur :</b> DOE, JOHN 123, RUE MAIN ANYTOWN ON K1A5T7		
				<b>3903 000 06</b> 
<b>elections.ca</b>				

**Në qoftë se jeni i regjistruar**, ju do të merrni kartën e informacionit të votuesit me postë, pasi zgjedhjet të shpallen. Ajo ju tregon se ku dhe kur mund të votoni. Silleni me vete këtë kartë së bashku me dokumentin ose dokumentat identifikues të pranueshëm kur të shkoni të votoni për ta bërë procesin e votimit më të lehtë.

**Në qoftë se ju nuk e merrni kartën ose të dhënat në kartë janë të gabuara**, ju mund të mos jeni i regjistruar ose të dhënat tuaja si votues mund të mos jenë përditësuar. Vizitoni **elections.ca** për t'u regjistruar ose përditësuar adresën tuaj, ose na telefononi në **1-800-463-6868** ose **1-800-361-8935 (për shurdh-memecët)** për asistencë. Ju gjithashtu mund të regjistrohni kur të shkoni të votoni.

## Për t'u regjistruar dhe për të votuar në zgjedhjet federale, ju duhet:

- Të jeni shtetas kanadez
- Të jeni të pakten 18 vjeç ditën e zgjedhjeve
- Të vërtetoni identitetin dhe adresën tuaj

# Mënyrat e votimit

**Ju mund të votoni pothuajse në çdo kohë gjatë periudhës së zgjedhjeve.**  
Zgjidhni alternativën e votimit që është më e mirë për ju.

## 1 Në ditën e votimit

Qendra juaj e votimit do të jetë e hapur për 12 orë (orët ndryshojnë sipas zonave orare)

## 2 Në ditët e votimit paraprak

Qendra e votimit që iu është caktuar do të hapet nga ora 09:00 deri në orën 21:00 të premten, të shtunën, të dielën dhe të hënën në javën para ditës së zgjedhjeve.

## 3 Me postë

Aplikoni deri ditën e martë ora 18:00 para ditës së zgjedhjeve. Ju do të votoni duke përdorur procesin e veçantë të votimit. Sigurohuni që ne t'a marrim votën tuaj **brenda ditës së zgjedhjeve**, ndryshe ajo nuk do të numërohet. Vizitoni **elections.ca** për më tepër informacion mbi afatet dhe të shikoni nëse votimi me postë është zgjedhja e duhur për ju.

## 4 Tek çdo zyrë të Elections Canada në të gjithë Kanadanë

Shkoni tek cilado zyrë e Elections Canada në të gjithë Kanadanë deri ditën e martë ora 18:00 para ditës së zgjedhjeve. Ju do të votoni duke përdorur procesin e veçantë të votimit. Pasi zgjedhjet të jenë shpallur, vizitoni **elections.ca** ose na telefononi për të gjetur zyrën e Elections Canada më të afërt.

Pasi të keni aplikuar të votoni me postë ose tek një zyrë e Elections Canada, kjo është e **vetmja** mënyrë votimi në këto zgjedhje.

Kontrolloni **kartën tuaj të informacionit të votuesit** se ku dhe kur mund të votoni

# Kini mjetet e identifikimit gati për të votuar

**Ju keni tre alternativa për të vërtetuar identitetin dhe adresën tuaj.**

Për të votuar, ju duhet të jeni shtetas kanadez dhe të jeni të paktën 18 vjeç ditën e votimit

## Alternativa 1



### Paraqisni një nga këto dokumenta identifikimi

- Lejen tuaj të drejtimit të automjetit
- çdo kartë tjetër të lëshuar nga qeveria Kanadeze (federale, provinciale/territoriale ose vendore) me fotografinë, emrin dhe adresën tuaj të tanishme

**ose**

## Alternativa 2



+



### Paraqisni dy dokumenta identifikimi

Të dy dokumentat duhet të kenë emrin tuaj dhe të paktën njëra duhet të ketë adresën tuaj të tanishme.

#### Për shembull:

- karta e informacionit të votuesit dhe deklarata bankare
- fatura e energjisë/ujit/gazit dhe karta e studentit

#### **Nuk i keni këto? Mos u shqetësoni!**

Ka dokumenta të tjera identifikimi që pranohen.

Shikoni listën e plotë tek **elections.ca**

**ose**

## Alternativa 3



+



### Në qoftë se nuk keni dokument identifikimi

Ju ende mund të votoni nëse deklaroni identitetin dhe adresën tuaj me shkrim dhe keni dikë, i cili ju njeh dhe është caktuar në qendrën tuaj të votimit dhe garanton që jeni ju.

Personi garantues duhet të jetë në gjendje të vërtetojë identitetin dhe adresën e vet. Një person mund të jetë garantues vetëm për një person (përveç në institucionet e kujdesit afatgjatë).

# Mjetet dhe shërbimet ndihmëse për votim



**Të gjithë zgjedhësve u caktohen qendrat e votimit për ditën e zgjedhjeve dhe ditët e zgjedhjeve paraprake.** Pasi zgjedhjet të shpallen, sigurohuni që qendra e votimit që i është caktuar të plotësojë nevojat tuaja për akses. Për të mësuar sa i aksesueshëm është:

- verifikoni kartën tuaj të informacionit të votuesit
- vizitoni **elections.ca** dhe futeni kodin tuaj postar në kutinë e Shërbimit të Informacionit të Zgjedhësit, ose
- na telefononi në **1-800-463-6868** ose **1-800-361-8935 (për shurdh-memecët)**

Nëse keni ndonjë shqetësim rreth hyrjes për në qendrën e votimit që i është caktuar, na telefononi në **1-800-463-6868** ose **1-800-361-8935 (për shurdh-memecët)**

Për të kërkuar ndihmë paraprake për votim, përfshirë përkthimin e gjuhës dhe gjuhën e shenjave, telefononi zyrën e Elections Canada në zonën tuaj elektorale deri në orën 18:00 të ditës së martë para ditës së zgjedhjeve.

## Mjetet dhe shërbimet ndihmëse për votim në ditën e zgjedhjeve



**Fletë-votimi më e madhe** me emrat e kandidatëve me **gërma të zmadhuara**




**Përkthim gjuhe dhe gjuhë shenjash** (dhe ndihmë tjetër me **kërkesë paraprake**)



**Gërma të zmadhuara** dhe lista e kandidatëve në **alfabetin braille**



**Ndihmë për të shënuar fletën tuaj të votimit** (Sillni dikë që njihni ose pyesni një punonjës zgjedhor)



**Model votimi me prekje dhe në alfabetin braille**



**Laps të madh** (sasi e kufizuar)  
Ju mund të sillni lapsin ose stilolapsin tuaj



**Zmadhues (4x)**



**Udhëzues firme**

**Shënim:** Listat në alfabetin braille të kandidatëve janë të disponueshme vetëm në ditën e zgjedhjeve. Gërmat e zmadhuara janë të disponueshme në ditët e votimit paraprak dhe në ditën e zgjedhjeve.